

UDHËZIM
Nr.14, datë 28.3.2011

**PËR NJOHJEN E TESTIMEVE DHE CERTIFIKIMEVE PËR GJUHËN ANGLEZE PËR
PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e listës së testeve të gjuhës angleze të njohura ndërkombëtarisht¹ (shih shtojcën 1), si kërkesë për përfundimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë të ofruara në institucionet e arsimit të lartë.

2. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të kompetencave gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët (KPERGJ) (shih shtojcën 2), shërben si standard në Republikën e Shqipërisë për gjuhët e huaja dhe testet gjuhësore.

3. Njohjen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) të testeve ndërkombëtare të gjuhës angleze të përcaktuara në shtojcën 1, të cilat:

- a) zhvillohen në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;
- b) kryhen nga subjekte, të cilat janë të certifikuara nga qendrat/organizatat që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testet dhe të drejtën e certifikimit bazuar në modalitetet e vendosura për zhvillimin e testeve ndërkombëtare të përcaktuara në shtojcën 1.

4. Përcaktimin e nivelit minimal të pranueshëm të kompetencës gjuhësore, si më poshtë vijon:

- a) Niveli B2 (kompetencë operative e mjaftueshme gjuhësore) për programet e ciklit të dytë “Master Profesional”;
- b) Niveli C1 (kompetencë operative e kënaqshme gjuhësore) për programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe për studimet e ciklit të tretë.

Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të përcaktojnë nivele të zotërimit të gjuhës angleze më të larta se ato minimale të përshkruara në pikat 4.a dhe 4.b të këtij udhëzimi.

5. Institucionet e arsimit të lartë të shpallin:

- a) listën e testeve të gjuhës angleze sipas shtojcës 1 (pjesë e këtij udhëzimi) dhe vlefshmërinë e tyre kohore;
- b) nivelet e kompetencës gjuhësore përkatëse për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë sipas pikës 4 të këtij udhëzimi;
- c) subjektet e parashikuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, me të cilat institucioni i arsimit të lartë ka nënshkruar marrëveshje të veçanta bashkëpunimi për ofrimin e testimit për studentët (nëse ka).

6. Institucionet e arsimit të lartë të përcaktojnë në statutet dhe në rregulloret e studimeve procedurat dhe modalitetet e dhënies së provimit të gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare dhe niveleve të kompetencës gjuhësore të përcaktuar në këtë udhëzim.

7. Qendrat/organizatat që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testet dhe të drejtën e certifikimit lidhin marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës me qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me testimin e gjuhës angleze të studentëve që ndjekin

¹ Njohje ndërkombëtare-nënkupton referencën që testi gjuhësor gëzon ndaj niveleve gjuhësore të përcaktuara sipas kuadrit gjuhësor të nënshkruar nga një vend. Në shtojcën 1 të këtij udhëzimi janë përfshirë testet që kanë referencë ndaj niveleve gjuhësore të përcaktuara sipas: i) Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët (KPERGJ) (Common European Framework of References for Languages (CEFR); ii) Shoqatës së Testuesve të Gjuhës në Europë – Association of Language Testers in Europe (ALTE) dhe iii) Kuadrit European të Kualifikimeve (KEK) European Qualification Framework (EQF).

programet e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem Tafaj